

SHPALLJE E REKRUTIMIT

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, më datë 25.03.2016 shpallë konkursin për plotësimin e vendeve të lira të punës:

I. ZYRTAR PËR NDËRTIMTARI- 2 pozita

Drejtoria: Drejtoria për emergjencë dhe shërbime publike

Njësia – Shërbime publike

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: koeficienti aktual- 7

Numri i referencës së vendit të punës: 01Nr.111-5139/16

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me menaxherin dhe stafin tjetër profesional për zbatimin e shërbimeve përkatëse; 20%
2. Kryen detyra të specializuara, sipas kërkesës në fushën profesionale specifike në përputhje me Ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara; 15%
3. Kryen detyra në fushën profesionale specifike në teren, me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë, me mbikëqyrje dhe udhëzime të kohëpaskohshme; 15%
4. Bënë hulumtime dhe analiza profesionale sipas kërkesës dhe kontribon në hartimin e rekomandimeve për shqyrtim, dhënien e këshillave profesionale si dhe hartimin e dokumenteve tjera të nevojshme; 15%
5. Merr pjesë në komisione apo grupe punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë; 10%
6. Bashkëpunon me organet përkatëse brenda institucionit dhe jashtë tij lidhur me implementimin e planeve dhe projekteve komunale dhe zhvillimin e punës në fushat e interesit të përbashkët; 10%
7. Raporton rregullisht të mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara; 10%
8. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe;

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilat kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedura e konkurimit: është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe atribute tjera që kërkohen:

- Diplomë universitare- në ndërtimtari/arkitekturë(pozita-1drejtimi konstruktiv dhe pozita-2 në arkitekturë)
- Minimum dy vite përvojë pune profesionale
- Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
- Shkathhtësi në komunikim dhe planifikim të punës ;
- Shkathhtësi vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathhtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Autocad, Archicad)dhe prog.edituese

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit : pa afat të caktuar

Data e mbylljes së konkursit; Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik, prej 25.03.2016 deri më 08.04.2016 .

Paraqitja e kërkesave: Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në shërbimin e shkrimore -**Zyra e pranimit**, kati përdhësë dhe në web-faqen komunale .

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Diplomën e Fakultetit të kryer apo Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën-ekstraktin e lindjes, çertifikata mbi trajnimet e kryera, dëshminë se nuk është në hetim.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

